



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 2 paragrafi 4 dhe nenit 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.01-16/1-21402 të datës 28.04.2025 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Islamic Relief Worldwide Zyra në Kosovë (IRW), Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 29.05.2025, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR ISLAMIK RELIEF WORLDWIDE – ZYRA NË KOSOVË (IRW)

I. MIRATOHET, Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 10.000.00 € (dhjetë mijë euro), konform Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.01-16/1-21402 të datës 28.04.2025 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Islamic Relief Worldwide zyra në Kosovë (IRW).

II. Ndarja e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Vendimi bëhet me qëllim të përmbushjes obligimeve që rrjedhin nga dispozitat e Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.01-16/1-21402 të datës 28.04.2025 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Islamic Relief Worldwide zyra në Kosovë (IRW), lidhur me zbatimin e projektit “Projekt i integruar për mbështetje në Shëndetësi, Arsim dhe Ekonomi Rurale në Kosovë” i cili implementohet nga Islamic Relief Kosova. Përfitues nga ky donacion do të jenë të rinjtë nga Komuna e Lipjanit ku do të përfitojnë grante për nisje të ideve biznesore.

III. Shuma e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Vendimi do të ndahet nga të hyrat vetanake të Komunës, kategoria ekonomike - subvencione dhe transfere të planifikuara për vitin 2025 për Drejtoratin për Bujqësi dhe Pylltari, kodi i programit 47003, fondi burimor 21/613/47003/200/00000/0421.

IV. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa, dhe Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari.

V. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 15-400/01-26988

Lipjan, më 29.05. 2025

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

